

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 27.03.2023*

27.03.2023
Ora 10:47

RENDI I DITËS

Shorti “Për caktimin e relatorit për kërkesën nr. 11, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për vendosje sanksioni administrativ”.

PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema**

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Sot datë 27 mars 2023 ora 10:45 hidhet shorti për caktimin e relatorit për kërkesën për vendosjen e sanksionit administrativ të përgatitur nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Referuar nenit 14 të rregullores së KASS-it janë përgatitur 5 shirita letre, ku në njërin është vendosur kërkesa për vendosjen e sanksionit administrativ, 4 shirita të tjerë janë të bardhë dhe pa shënime të cilat pasi palosen nga një përfaqësues i KQZ –së në gogla me peshë ngjyrë dhe formë të njëjtë hidhen në një enë transparente:

-Pasi futen të 5-ë goglat te ena transparente përzgjidhen nga përfaqësues i KQZ-së, duke qënë se antarët e KASS-it janë në mungesë dhe kanë autorizim për t’i tërhequr, në emër në llogari të tyre, duke filluar nga rendi alfabetik rritës, me zotin Ervin Lako të parin, atëherë përzgjidhen goglat:

- Hidhet një nga goglat, -Tërhiqet gogla për:

Z. Ervin Lako: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.27.03.2023*

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Elvis Çefa: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Ilirjan Rusmali. - Tërhiqet gogla - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

-Vazhdojmë në emër dhe për llogari të:

Z. Koli Bele: - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Dhe në fund :

Z. Ledio Braho: Kërkesa e Komisionerit numër 11.

Atëhere jemi në përfundim të procedurës së shortit relatori i kërkesës së Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosje sanksionesh administrative është zoti Ledio Braho, ju, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

